



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a** dhe nenit 34.1, shkronja **d**, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 14.06.2021, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi-A" SHPK.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 1794-21, me sip. 345m², Zona kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perendim", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 1793-1, sip. 345 m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Tahir (Liman) Sylejmanit dhe "Agullimi-A" SHPK, me destinim rrugë e planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perendim", i miratuar me Vendimin nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë pasi që nuk ekzistojnë parcela të tjera komunale të përshtatshme për realizimin e Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perendim", i miratuar me Vendimin, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, në Prishtinë.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.
- VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Arsyetim

Drejtoria e Urbanizmit në bazë të Vendimit për përcaktimin e kushteve ndërtimore, nr. 05, nr. 350/02-14079/21, dt.28.04.2021, ka dhënë pëlqimin për këmbimin e pjesës së parcelës kadastrale nr. 1794-21, me sip. 345m², Zona kadastrale Prishtinë, me destinim ndërtim sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013, kurse prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është parcela kadastrale nr. 1793-1, sip. 345m², Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Tahir Sylejmanit dhe "Agullimi-A" SHPK, me destinim rrugë e planifikuar sipas Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin, nr. 01, nr. 35-186850, dt. 02.10.2013.

Procedura e këmbimit të pronës komunale me pronë private, është duke u zhvilluar në bazë të nenit 25 të Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019).

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet këmbimi i pronës komunale me pronë private siç është përshkruar në pikën II të dispozitivit të këtij propozimi.

Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/03-112353/21, më 16.06.2021

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

